



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-GROUPE



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-GROUPE



Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 19.10.2022

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILMJE:

Nr.No.Br.

24.10.2022

02/501

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 14, nenit 17 shkronja (c), nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit nr.02/L-53 për Gjuetinë, Udhëzimi Administrativ nr.06/2009 për dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta, neni 10 paragrafi 1 pika (h) nenit 19 paragrafi 1 shkronja (a), nenit 46, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, kërkesës nr.08/441 datë:06.10.2022 së Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e shtatë (VII) të rregullt të mbajtur me datë: 18.10.2022 merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa nr.08/441 datë: 06.10.2022 e parashtruar nga drejtorja për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, për shfuqizimin e vendimit për themelimin e vendgjuetisë në komunën e Malishevës, vendimi me nr.02/211 të datës, 05.05.2022.
2. Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi themelimi i vendgjuetisë në komunën e Malishevës caktohet në dy zona për vendgjueti të përbashkët, zona 1 dhe zona 2, bazuar në Ligjin për Gjuetinë, respektivisht në Udhëzimin Administrativ MA-NR 10/2007.
3. Bazuar në nenin 3 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ nr.06/2009 për dhënien në menaxhim të vendgjuetive të përbashkëta, procedurat për dhënien me qira të vendgjuetisë bëhen përmes procedurës së ofertës publike e cila do shpallet pas themelimit të vendgjuetisë.
4. Obligohet drejtorja për gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësor-juridik që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të zbatoj të gjitha procedurat për përcaktimin e pikave përkufizuese të lokacionit të caktuar dhe të evidentohet në librat kadastral të Komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe shërbim pronësor-juridik.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK), nr.10/2019 për shqyrtimin administrative të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar, me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

1. MAPL-së ,
2. Drejtorive kompetente
3. Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaqi



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 06.10.22
PRIMLJENO:

Nr. No. Br.

08/441



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

PROTOKOLI:	08/
DATA:	06.10.2022
PËR:	Kryetarin e Komunës z. EKREM KASTRATI
NGA:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Sylë Dukolli
TEMA:	Kërkes: Për Shfuqizimin e Vendimit për Themelimin e Vendgjuetisë në Komunën e Malishevës me nr. 02/211 të datës 05.05.2022, si dhe Aprovimi i Vendimit të ri sipas pelqimit të MBPZHR-së.

Kërkojmë nga ana juaj z. Kryetar Ekrem Kastrati që të kerkoni nga Asambleja Komunale e Malishevës që të shfuqizoj vendimin e themelimit të vendgjuetisë me nr.02/211 të datës 05.05.2022, për arsye se me një vendim të tillë për themelimin e Vendgjuetive të përbashkta në Komunën tonë përfshihen vetëm 1/3 e sipërfaqeve të përgjithshme të lejuar në tërë teritorin Pyjorë të Malishevës, që ka qenë vetëm 10,000 ha.

Njëherit të aprovohet një vendim i ri duke u bazuar në Pelqimin e MBPZHR të datës 10/02/2009, ku përcaktohen dy zona për vend gjueti të përbashketa në Komunën e Malishevës, Zona 1 dhe Zona 2 si dhe bazuar në Ligjin për gjueti respektivisht në Udhëzimin administrativ MA-NR 10/2007.

Në pelqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me nr.280/2 të datës 10.02.2009 figurojn 30,585.34ha sipërfaqe pyjore në Komunën e Malishevës të ashtëquajtura:

- ✦ "Malisheva 1" me sipërfaqe të përgjithshme prej 16,241.05 ha dhe
- ✦ "Malisheva 2" me sipërfaqe të përgjithshme prej 14,344.29 ha

Poashtu në konsultime me organet kompetente të Ministrisë për Pylltari dhe Gjueti na është sugjeruar që sa më shpejtë duhet të nxjerrët një vendim nga Kuvendi për themelimin e